



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.400/01-25102/22
Kaçanik, 29.09.2022

Në mbështetje të nenit 24 dhe 40.2(b) të Ligjit nr.03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 61 të Ligjit nr.03/L-048 -Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/3 Qershor 2008), të nenit 2 të Ligjit nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/3 Qershor 2008), të Qarkores Buxhetore të MFPT 2023/02, të nenit 61.1 lidhur me nenin 34.5 dhe 6.1 të Statutit të Komunës 01Nr. 60/01-12895/20, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr.400/01-25102/22 prej datës 01 shtator 2022, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 29 Shtator 2022, mori këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT
PËR VITIN FISKAL 2023 DHE VLERËSIMET PËR VITET 2024 - 2025

1. Buxheti total i Komunës së Kaçanikut për vitin buxhetor 2023 është në shumë prej 10,674,689.00€, ndërkaq për vitin 2024 vlerësimet e projektuara janë në masë monetare prej 11,371,010.00€ dhe për vitin 2025 në shumë prej 11,823,987.00€.
2. Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin buxhetor 2023, sipas pikës 1. të këtij vendimi, mjetet nga Grantet qeveritare janë në shumë prej 9,812,111.00€, që shënojnë pjesëmarrje me 91.92% dhe të Hyrat Vetanake Komunale, në shumë prej 862,578.00€, me një pjesëmarrje prej 8.08% në strukturën e përgjithshme të Buxhetit.
3. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin buxhetor 2023, parashikohen të jenë për Shpenzime Operative, shuma prej 7,703,376.00€ dhe për Investime Kapitale, shuma prej 2,971,313.00€.
4. Shpenzimet buxhetore për vitin 2023, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve, parashikohet të kenë këto ndarje e të cilat janë në përputhje të plotë me Qarkoren Buxhetore 2023/02 të datës 15.08.2022 të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve (MFPT):

4.1 Shpenzimet për Paga dhe Mëditje	5,621,607.00 €
4.2 Shpenzimet e Mallrave dhe Shërbimeve	1,498,269.00 €
4.3 Shpenzimet e Shërbimeve Komunale	193,500.00 €
4.4 Subvencionet dhe Transferet	390,000.00 €
4.5 Shpenzimet në Investime Kapitale.....	2,971,313.00 €
5. Për zbatimin e këtij Vendimi për Buxhetin e Komunës, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.
6. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli